



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03, prill 2019), në bazë të nenit 29, të Rregullores nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme dhe në bazë të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

## V E N D I M


### **PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 01. 463/01-139108/20, TË DT. 12.08.2020, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-139108/20, i dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme, në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim - ndryshimi nënkupton:
- I. Ndryshohet pika II e vendimit, përmirësohen parcelat me nr. 01673-0, 01664-4, 01663-1, ku në vend të tyre, vendosen numrat e rinj të parcelave, si në vijim:
1. Parcela nr. 01673-3, me certifikatë të pronësisë nr. P-71914059-01673-3, ZK Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues " Prishtina e re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013 dhe
  2. Parcela nr. 1664-5, me certifikatë të pronësisë nr. P-71914059-01664-5, ZK Prishtinë, me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues " Prishtina e re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 035-186861, dt. 02.10.2013, në pronësi të Ismail Shillovës dhe parcela nr. 01663-6, me certifikatë të pronësisë nr. P-71914059-01663-6, ZK Prishtinë, me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues " Prishtina e re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013, në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues " Prishtina e re - Zona Qendër" në Prishtinë.

- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
  - kopjet e planit dhe
  - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-27238/21, më 11.02.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**



## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 12.08.2020, ka miratuar Vendimin nr.01.463/01-139108/20, dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private.

Drejtoria e Pronës gjatë shqyrtimit të lëndës, ka vërejtur se janë bërë disa ndryshime në regjistrat kadastralë, në parcelat nr. 1673-0, me sipërfaqe prej 1176m<sup>2</sup>, Zona kadastrale, Prishtinë, pronë e Komunës së Prishtinës, parcela kadastrale nr.1664-4, me sipërfaqe prej 805m<sup>2</sup>, pronë e Ismail Shillovës, parcela kadastrale nr.1663-1, me sipërfaqe prej 331m<sup>2</sup>, pronë e Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Ndryshimet në regjistrat kadastralë janë bërë gjatë kohës sa pronat e lartcekura ishin në proces të këmbimit, dhe pronat e lartcekura tani në regjistrat kadastralë janë të regjistruara si parcela nr. 1673-3, pronë e Komunës së Prishtinës, parcela nr. 1664-5, pronë e Ismail Shillovës dhe parcela nr.1663-6, pronë e Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Andaj, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për prona të njëjta, por vetëm kanë ndryshuar numrat, kërkohet të bëhet plotësim-ndryshimi i Vendimit nr. 01.463/01-139108/20, dt.12.08.2020, pika II, ku duhet të përmirësohet, të hiqen parcelat kadastrale nr. 1673-0, me sipërfaqe prej 1176m<sup>2</sup>, Zona kadastrale, Prishtinë, pronë e Komunës së Prishtinës, parcela kadastrale nr. 1664-4, me sipërfaqe prej 805m<sup>2</sup>, pronë e Ismail Shillovës, parcela kadastrale nr. 1663-1, me sipërfaqe prej 331m<sup>2</sup>, pronë e Faik Breznicës dhe Osman Breznicës, Zona kadastrale, Prishtinë, dhe në vend të tyre duhet të jenë parcelat kadastrale nr. 1673-3, pronë e Komunës së Prishtinës, parcela nr. 1664-5, pronë e Ismail Shillovës dhe parcela nr. 1663-6, pronë e Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.